

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
"DATA STORM" SHPK

Sot më datë 21.08, 2025, në Tiranë, ortaku themelues:

Z. Ermal Beqiri, shtetas shqiptar, lindur më 23.01.1982, në Gjirokastrë, banues në Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr. personal I20123025V, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;*
- *Ligji Nr. 9901, Dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";*
- *Ligji Nr. 9723, Dt 03.05.2007, "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";*
- *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;*
- *Ligji nr. 58, datë 14.07.2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore".*

Miratojë këtë statut të shoqërisë tregtare "Data Storm" Sh.p.k. e cila ka formën juridike e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (sh.p.k) si një shoqëri e së drejtës shqiptare, e cila do funksionojë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me Statutin, siç vendoset më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni

Emërtimi i shoqërisë

Ortaku vendosi që shoqërinë ta emërtojë "Data Storm" sh.p.k., poshtë e quajtur edhe "Shoqëria".

Neni 2

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë "Data Storm" sh.p.k është në adresën: **Durana Tech Park, Rruga Ahmet Zogu, nr. pasurise 336, Z.K. 3852, Njesia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, kodi postar 2013.**

Neni 3

Kohezgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në QKB.



Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë tregtare "Data Storm" sh.p.k është si më poshtë:

Data Storm, do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Zhvillimi i softuerit të personalizuar për klientë të sektorëve publikë dhe privatë, duke përfshirë projekte të integruara dhe zgjidhje të përshtatura sipas kërkesave specifike.
- Analiza e të dhënave në shkallë të gjerë (Big Data Analysis), përpunimi, interpretimi dhe transformimi i të dhënave të strukturuar dhe të pashkallëzuara në njohuri të zbatueshme për vendimmarrje.
- Zhvillimi dhe implementimi i zgjidhjeve me inteligjencë artificiale (AI) dhe algoritme të të mësuarit makinerik (Machine Learning) për automatizim procesesh, parashikim tregjesh, optimizim burimesh dhe përmirësim të performancës organizative.
- Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të avancuara analitike dhe platformave mbështetëse të vendimmarrjes me bazë AI dhe analiza të të dhënave në kohë reale.
- Projektimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve cloud dhe shërbimeve të infrastrukturës së teknologjisë cloud, duke përfshirë menaxhimin e platformave dhe ofrimin e zgjidhjeve të integruara për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave.
- Shërbime të sigurisë kibernetike (Cybersecurity), auditim sigurie, pajtueshmëri me standardet ligjore dhe mbrojtje nga kërcënimet kibernetike.
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve ERP dhe CRM të personalizuar, si dhe platformave të tjera digjitale të menaxhimit të proceseve të biznesit.
- Zhvillimi i aplikacioneve mobile për rritjen e aksesit dhe angazhimit të përdoruesve.
- Shërbime konsulence në fushën e IT-së dhe mbështetje për proceset e transformimit digjital.
- Organizimi i trajnimeve, workshopeve dhe programeve të certifikimit në fushat e zhvillimit të softuerit, analizës së të dhënave, inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe teknologjive cloud.
- Kryerja e projekteve kërkimore dhe bashkëpunimeve inovative me universitete, qendra kërkimore dhe kompani teknologjike, brenda dhe jashtë vendit.
- Import-eksporti i pajisjeve, mjeteve dhe teknologjive të nevojshme për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative.
- Aktivitete të tjera të lejuara me ligj që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e sipërpërmendur dhe që shërbejnë për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5

Ndryshimet

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen, dhe objektin e veprimtarisë së saj pas vendimeve që do marrë asambleja e përgjithshme.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë

6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lek, i investuar në masë plotë prej ortakut Ermal Beqiri.



6.2. Kapitali themeltar është i përbërë prej 1 kuote.

6.3. Z. Ermal Beqiri zotëron 100% (njëqind përqind) të kuotave të shoqërisë, 1 (një) kuotë.

Neni 7

Organet drejtuese

7.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë që perbehet nga ortakët
- Administratori

Neni 8

Rregulla të përgjithshme për Asamblenë e Ortakut të Vetëm

8.1 Ortaku i vetëm ka të drejtë të marrë pjesë dhe të vendosë për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të Asamblesë së Ortakëve, duke disponuar numër votash të barabartë me të gjitha kuotat e kapitalit themeltar që zotëron.

8.2 Vendimet e Asamblesë merren nga ortaku i vetëm dhe mund të shprehën me shkrim ose me çdo mjet tjetër, përfshirë ato elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i tij dhe shprehja e vullnetit të plotë.

8.3 Në rast se parashikohet zhvillimi i një mbledhjeje formale, ortaku i vetëm njoftohet me shkrim, përmes postës elektronike, të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orarin.

8.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori i Shoqërisë, ose, në mungesë të tij, nga eksperti kontabël i autorizuar (nëse ka).

8.5 Çdo mbledhje e thirrur në mënyrë të parregullt mund të shpallet e pavlefshme, përveç rasteve kur ortaku i vetëm është i pranishëm ose i përfaqësuar.

8.6 Ortaku i vetëm vendos për çështje të tilla si:

- Emërimi ose shkarkimi i administratorit, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuidatorëve.
- Miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit.
- Miratimi i llogarive vjetore, ndarja e fitimit, etj.
- Ndryshimi i Statutit.
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar.
- Vendosja e pengut mbi kuotat e kapitalit themeltar.
- Disponimi i pasurive të shoqërisë.
- Transferimi i kuotave tek të tretët.
- Pjestimi ose anulimi i kuotave.
- Zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë, shpërbërja dhe kalimi në proces likuidimi.
- Shtimi i objektit të aktivitetit.
- Ndryshimi i emërimit ose adresës së selisë.

8.7 Për çështje të tjera që nuk kërkojnë shumicë të cilësuar, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 9 të Statutit.

8.8 Asambleja drejtohet nga administratori dhe, në mungesë të tij, nga një person i caktuar nga ortaku i vetëm.

8.8 Asambleja drejtohet nga administratori dhe, në mungesë të tij, nga një person i caktuar nga ortakut i vetëm.

8.9 Ortaku i vetëm mund të revokojë në çdo kohë vendimet e marra, kur e çmon se kjo i shërben interesave të shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

- Administrator i shoqërisë caktohet për herë të parë për një periudhë 4 (katër) vjeçare Z. Ermal Beqiri, shtetas shqiptar, lindur më 23.01.1982, në Gjirokastrë, banues në Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr. personal I20123025V, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Afati i mandatit të administratorit fillon me regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe ka një kohëzgjatje prej 4 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.
- Administratori ka të gjitha kompetencat, të cilat i deklaron se i njeh dhe i pranon, për të kryer të gjitha detyrimet që lindin në bazë të statutit të shoqërisë dhe në mënyrë të veçantë nga ligji tregtar në fuqi.

Neni 10

Kompetencat e Administratorit

- Administratori, i cili është njëkohësisht ortakut i vetëm i shoqërisë, drejton të gjithë veprimtarinë e saj nga pikëpamja tekniko-organizative dhe kryen të gjitha veprimet që i gjykon të nevojshme për realizimin e objektit të shoqërisë, me përjashtim të atyre që ligji dhe ky statut ia rezervojnë si vendime formale të tij në cilësinë e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- Përfaqëson shoqërinë para të tretëve.
- Kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin mbi ecurinë e veprimtarisë; së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimit, i miraton vetë në cilësinë e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- Vendos, në cilësinë e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, për politikën tregtare dhe për veprimtarinë me rëndësi të veçantë për shoqërinë, duke siguruar ligjshmërinë e punës dhe mbarëvajtjen e aktivitetit.
- Lidh marrëveshje, kontrata dhe kryen veprime të tjera juridike, përveç atyre që kërkojnë vendim formal në cilësinë e Asamblesë së Ortakut të Vetëm sipas ligjit tregtar dhe këtij statuti.
- Përcakton strukturën organizative të shoqërisë, kompetencat e secilit sektor dhe planin e zhvillimit të aktivitetit.
- Emëron dhe shkarkon personelin administrativ të shoqërisë dhe përcakton pagat e tyre.
- Merr vendime për marrëdhëniet financiare të shoqërisë, si dhe për marrëdhëniet financiare me persona të tretë.



- Menaxhon aktivitetin financiar, përfshirë fitimet e mundshme dhe propozimet për caktimin e ekspertëve kontabël (nëse parashikohet).

Shkarkimi i Administratorit

Meqenëse administratori është njëkohësisht ortaku i vetëm, ai mund të:

- Jepë dorëheqjen me deklaratë të vetëfirmosur.
- Vendosë vetë për përfundimin e mandatit të administratorit, në cilësinë e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- Për rastet kur ligji parashikon shkarkim të detyruar (p.sh. pamundësi ligjore për ushtrimin e detyrës), vendimi formal merret nga ortaku i vetëm në cilësinë e Asamblesë së tij.

Çdo pretendim i lidhur me shkaqet e lirimit nga detyra dhe/ose kërkesat për dëmshpërblim shqyrtohen nga gjykata kompetente, sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.

Neni 12

Kontrolli i brendshëm

Shoqëria “Data Storm” Shpk organizon kontrollin e brendshëm me ekspert kontabël të autorizuar, të cilët caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 13

Dispozita Financiare

- Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Viti i parë nis nga data në të cilën Shoqëria është njohur ligjërisht, deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- Me mbylljen e vitit financiar, administratori merr masa për hartimin e bilancit të vitit financiar të mbyllur.
- Për sa i përket kontabilitetit, zbatohen rregullat e përcaktuara nga ligji shqiptar në fuqi.

Neni 14

Trashëgimia

Pasuria e shoqërisë është lirisht e trashëgueshme me anë të trashëgimisë siç e njeh legjislacioni në fuqi.

Neni 15

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

Në rastin e prishjes dhe likuidimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 16

Dispozita të tjera

- Për të gjitha çështjet e tjera që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” edhe aktet e tjera ligjore/nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- Mosmarrëveshjet eventuale gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, ndërmjet ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar dhe gjykatës kompetente e cila do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Z. Ermal BEQIRI

